



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239171

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06013298

AC-I-23-0172

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

F B, Prishtinë.

kundër

E paditura

NSH Amortizatorët(në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2812 të datës 01 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 02 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është bazuar.**
- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-2812 i datës 01 mars 2023.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim në Shkallë të parë të DHPGJS tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 04 nëntor 2013, pranë DHPGJS, paditësi ka parashtruar ankesë, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tuje AL) PRN047-0212, të dt. 08 tetor 2013, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për anulimin e ndarjes së mjeteve financiare të inkasuar nga pagesa e qirasë dhe kompensimi në shumën shtesë prej 712.96€ nga NSH „Amortizatorët”(në likuidim). Në vendimin e AL thuhej se interesat e parashtruesit të kërkesës janë përmbushur rregullisht dhe se parashtruesi i kërkesës shikuese edhe punëtorët tjetër janë njoftuar rregullisht mbi shpërndarjen mjeteve dhe ka pasur të drejtë të parashtronte ankesë. Paditësi ka bashkangjitur Vendimin e AL PRN 047- 0212.

Më 27 shtator 2018, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje me të cilën ka kërkuar kërkesa të hedhet apo të refuzohet si e pabazuar. Ka theksuar se lëndë e kësaj kërkesë është vetëm ligjshmëria e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit sipas nenin it 70.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033, që parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër Vendimit të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me ligjin 04/L-034.

Më 02 tetor 2018, paditësi ka dorëzuar një parashtresë per përgjigje ndaj mbrojtjes. Ai thekson se objekt i kërkesës është ndarja e të hyrave nga qiraja e objekteve të ndërmarrjes. Ka shtuar se të gjithë punëtorët të cilët kanë përfituar nga qiraja e objekteve të NSH kishin të njëjtin status por që me ndarjen e këtyre mjeteve të punëtoreve janë bërë diskriminim individual duke bërë ndarja pa kritere nga një grup i punëtorëve, ku paditësit i është ndarë një shumë simbolike. Vendimi nuk i është dorëzuar asnjë punëtori dhe se vendimi me publikim në tabelën e shpalljes ka shkelur të drejtën elementare.

Me 16 tetor 2018, e paditura ka parashtruar kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së paditësit dhe ka theksuar se mbetet në tersi pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të parashtruara duke theksuar se vendimi AL është i sakti dhe i drejtë ndërsa ankesa e paditësit është e pabazuar.

Më 02 gusht 2022, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar si për paditësin ashtu edhe për të paditurin. Paditësit ju është kërkuar të sqarohet sa i përket shkaqeve të ankesës, cili anulim i ndarjes së mjeteve po kërkohet, a' ka ndonjë vendim me të cilin janë caktuar kriteret për shpërndarje të hyrave të grumbulluara nga qiraja, shuma e caktuar, etj. Ndërsa AKP-së, ju është kërkuar të sqarohet në lidhje me vendimin PRN 047- 0212, sepse nuk është shumë i qartë.

Më 19 gusht 2022, paditësi ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar në lidhje me kërkesën e tij, ka theksuar NSH Amortizatorët kishin inkasuar shumën prej 2,537.000€, neto, në emër të qiradhënies së hapësirave të saja afariste . Një komision kishte përpiluar raportin nr. 333/1, të dt. 04 nëntor 2010, për shpërndarjen e këtyre mjeteve. Komisioni gjoja ishte themeluar nga Këshilli i punëtorëve përkundër faktit se nuk ka prova as procesverbal për themelimin e këtij komisioni. Komisioni kishte caktuar kriterin e shpërndarjes 85% të mjeteve për punëtorët aktiv dhe 15% të mjeteve për punëtorët pasiv. Raporti i hartuar është nënshkruar vetëm nga Kryetari i Komisionit, por jo edhe nga anëtarët e tjerë. Kjo ndarje është aprovuar me Vendimin e Bordit Menagjues, të NSH Amortizatorët. Vendimi nr. 379/1, datë 23 dhjetor 2010, i Bordit Menagjues ka parapara se ai do të publikohet në tabelë të shpalljeve të ndërmarrjes, pra ai vendim nuk ju është dorëzuar asnjë herë punëtorëve. Paditësi kishte pretenduar se kriteri për shpërndarje të mjeteve i caktuar nga Komisioni në raportin 85% me 15 % të mjeteve ka diskriminuar punëtorët të cilët janë pasiv në raport me punëtorët aktiv. Vendimi për shpërndarje nuk u është dorëzuar asnjë here punëtorëve pasiv përfshirë këtu edhe paditësin. Në rastin konkret paditësi është dëmtuar në shumën 5,784.61€. Kësaj parashtrese ja ka bashkangjitur: Kontratën e punësimit, datë 03 tetor 2001, Raporti i Komisionit për shpërndarje të mjeteve të inkasuar nga qiraja, datë 04 nëntor 2010, Vendim i nr. 379/1, datë 23 dhjetor 2010, i nënshkruar nga Kryetari i Bordit Menagjues, Ekstrakti i procesverbalit nr. 36/1, më datë 21 shkurt 2011.

Më 19 gusht 2022, AKP-ja, përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën e paditësit duke u bazuar në nenin 37, paragrafi 9.2, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-

034, që parashikon ,, Përveç bazave të tjera për kundërshtim të kërkesës AL gjithashtu ka të drejtë pa kufizime që të kundërshtoi një kërkesë tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin se kërkesa është përmbushur në mënyra të tjera ..".AL pasi ka shqyrtuar dokumentacionin në arkiv të gjetur në NSH , konstatoi se në bazë të raportit të Komisionit për shpërndarje të mjeteve të inkasuara nga qiraja e UNMIK , dt. 04.11.2010, shuma e qirasë për shfrytëzim të objekteve- hapësirave ishte 2,537,000.00€, është shpërndarë shuma në favor të Administratës Tatimore të Kosovës dhe shuma e mbetur 2,160.380.48 € u është shpërndarë punëtorëve të NSH –së. Ankesat e punëtorëve ndaj Vendimit më të lartë janë shqyrtuar nga ky Komision dhe Vendimi dt. 07.02.2011, ka qenë i publikuar edhe në tabelë të shpalljeve dhe ankesat janë shqyrtuar nga Bordi Menagjues i NSH me anë të vendimit 05.04.2011.

Në parashtresë është deklaruar se parashtresuesi i kërkesë është njoftuar në mënyrë të rregullt mbi shpërndarjen dhe ka pasur të drejtë të parashtroi çdo ankesë ndaj shumës së përfituar. Ka kërkuar të refuzohet kërkesa. Parashtresës ja ka bashkangjitur: Formularin e kërkesë kreditore, datë 14 mars 2013, Kontratën e punësimit për paditësin, Njoftimi për ushtrimin e padisë në gjykatë datës. 23 mars 2011, si dhe Padinë për anulimin e ndarjes së metëve financiare, të datës 28 mars 2011, vendim e AL.

Shkalla e parë më datë 10 shkurt 2023, ka caktuar dhe ka mbajtur seancë dëgjimore publike.

Me 01 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-2812, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar, e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN047-0212 të datës 08 tetor 2013. Në arsyetim të aktgjykimit thuhet se Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi, ishte punëtor me status pasiv i të paditurës NSH ,, Amortizatorët ", pas luftës e deri në vendimin e Bordit të AKP-së, për likuidim të NSH. Nuk është kontestuese fakti se NSH – objektet e saj në Prishtinë, me qira i ka shfrytëzuar UNMIK për një periudhë të caktuar, dhe shuma që NSH ka realizuar nga qiraja është 2,537.000.00€. Nuk

është kontestuese as fakti se NSH –ja bazuar në Vendimin e Këshillit të punëtorëve ka formuar një Komision për shpërndarjen e mjeteve të inkasuar nga qiraja e realizuar nga qiramarrësi UNMIK , për punonjësit e NSH –së dhe Komision ka hartuar raportin me shkrim nr. 333/1, dt. 04.11.2010 . Sipas këtij raporti, janë identifikuar punëtorët aktiv, punëtorët në pritje, punëtorët të cilët kanë vdekur, punëtorët të cilët kanë poseduar kontrata të punës te institucionet tjera dhe punëtorët të cilët kanë jetuar në boten e jashtme.

Shkalla e parë ka arsyetuar se me këtë raport janë caktuar kriteret për punëtorët të cilët kanë qenë punëtor aktiv që shpërndarja të jetë 85%, ndërsa për punëtorët pasiv 15 %. Për punëtorët aktiv janë shpërndarë mjetet në shumën 1,648.485,22€, për punëtorët pasiv në shumën 263.092,61€, për punëtorët e vdekur aktiv shuma 82,153,26€, dhe për punëtorët pasiv të vdekur shuma 26.567.00€. Ky raport është aprovuar me vendimin e Bordit të Menagjues, më datë 23 dhjetor 2010.

Komisioni i NSH ka bërë shqyrtimin e ankesave dhe më datë 21 shkurt 2001, pjesërisht ka aprovuar ankesat individuale dhe një numër të ankesave i ka refuzuar ndër ta edhe është refuzuar ankesa e paditësit. Paditësi dhe punëtorët tjerë kanë ushtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Suprem më datë 28 mars 2011, me shenjë SCC – 11- 01117. Për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit, Dhoma e ka pezulluar procedurën për padinë e punëtorëve sipas aktvendimin SCC – 11- 0117, më datë 07 tetor 2015 .

Me Vendimin e AL, PRN047- 0212, datë 08 tetor 2013, është refuzuar kërkesa e Fejzë Berishës me të cilën kërkon anulimin e ndarjes së mjeteve financiare të inkasuar nga pagesa e qirasë së NSH ,, Amortizatorët ”dhe kompensimin e shumës 712.96€. Vendimi është mbështetur në nenin 37, paragrafi 9.2, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Shkalla e parë ka arsyetuar se në rastin konkret, kërkesa e paditësit nuk është e bazuar me vetë faktin se në procedurë të likuidimit ushtrohen vetëm kërkesa financiare, ndërsa kërkesat në lidhje me kundërshtimin e vendimeve të NSH –së , për realizimin e ndonjë të drejte ato shqyrtohen në procedurë të rregullt gjyqësor. Në rastin konkret pavarësisht se është pezulluar procedura sipas rastit SCC- 11- 0117 , që është vepruar sipas nenit 10, paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-

034, procedura e pezulluar sipas nenit 10, paragrafi 3 i të njëjtit ligj ajo mundë të vazhdoi vetëm me miratimin e kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

Në rastin konkret si çështje paraprake e kërkesës së paditësit në procedurë të likuidimit, është vlerësimi i vendimeve të NSH –së, në lidhje me kriteret për shpërndarjen e të hyrave të grumbulluara nga qiraja për punëtorët e NSH –së . Pra nisur nga fakti se padia e punëtorëve të NSH-së të cilët janë të pa kënaqur me Vendimet e NSH-së , për këtë shpërndarje, si grup i punëtorëve në cilësinë punëtorëve pasiv, në rastin konkret kërkesa e paditësit si punëtor individual për tu anuluar kjo shpërndarje dhe shuma e kërkuar tani për tani në procedurë të likuidimit është e varur nga vendosja e padisë grimore në procedurë të rregullt. Në rastin konkret AL drejt ka vepruar kur në procedurë të likuidimit e ka refuzuar kërkesën e paditësit dhe ka zbatuar nenin 37, paragrafi 9.2, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Shkalla e parë ka vlerësuar se përderisa të mos jenë anuluar Vendimet e NSH –së për këtë shpërndarje, paditësit i mungon baza juridike të kërkoj çfarëdo shume që pretendon se atij i takojnë më shumë se ajo shumë që ju është aprovuar nga NSH –ja , për ta realizuar në procedurë të likuidimit. Me nenin 42 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është paraparë që të formohet një fond rezervë për kërkesat që janë në kontest dhe që ende nuk janë zgjedhur nga Gjykata, siç është rasti i procedurës së pezulluar sipas padisë SCC- 11- 0117.

Me 22 mars 2023, paditësi/ ankuesi për mes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2812 të datës 01 mars 2023. Paditësi me ankesë ka kërkuar që të priset Aktgjykimi i ankimuar ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje apo ta ndryshoj at dhe ta aprovojë në tersi kërkesën e paditësit. Paditësi tutje ka theksuar se në këtë çështje gjykata me rastin e refuzimit të ankesës/ kërkesës ka aplikuar gabimisht dispozitat procedurale dhe ato materiale pasi që aktgjykimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare dhe arsyet e dhëna janë në kundërthënie me faktet e vërtetuara në procedurë. Aktgjykimi në arsyetim në pjesën më të madhe përshkruan rrjedhën e procedurës në këtë çështje kontestimore dhe nga ky përshkrim përfundohet se këtu

paditësi-ankuesi fillimisht kishte iniciuar procedurë me padi ndaj NSH, padi kjo e regjistruar me numrin SCC-11-0117. Padiësi ka shtuar se aktgjykimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare të çështjes karrshi kërkesës fillestare të padiësit/ankuesit. Tek AL është specifikuar saktë se padiësi/ankuesi kërkon anulimin e shpërndarjes së shumës së caktuar të inkasuar nga qiradhënia dhe që ti paguhet shuma e specifikuar në kërkesë.

Gjykata në aktgjykim nuk shpjegon në rastin konkret mjaftohet me thirrjen në dispozitë ligjore për përfundimin e tillë. Përfundimi i gjykatës është në kundërshtim edhe me qëndrimin e Kolegjit të Apelit i dhënë në aktvendimin AC-I.-14-0346-A0001 të datës 30 korrik 2015 i dhënë për objektin e njëjtë të kërkesës sipas ankesës të një punëtori tjetër të NSH të njëjtë. Rikujtojmë e se të gjitha pretendimet e parashtruara nga padiësi gjatë procedurës së shkuar dhe në seancën e datës 10 shkurt 2023 janë konfirmuar me qëndrimet e dhëna nuk bëhet fjalë se nuk kemi të bëjmë me kërkesë financiare dhe se kërkesa e padiësit ankuesit mund të zgjidhet në procedurën e rregullt sipas padisë së iniciuar SCC-11-0117. Theksojmë se ankuesi në çështjen ku është nxjerrë vendimi i cekur (AC-I—14-0346-A0001) është njëri nga padiësit bashkë me këtu ankuesin/padiësin në kontestin SCC-11-0117.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këta parashtresë AKP-ja pohon se e mbështet në tersi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankueses si të pabazuara. Tutje AKP-ja pohon se qëndron ende pranë gjitha thënieve dhe provave të paraqitura para Shkallës së I-rë të DHPGJS në rastin C-IV-13-2812, me të cilat AKP-ja i ka hedhur poshtë të gjithë pretendimet e padiësit në ankesën e tij, dhe këto argumente nuk do të përsëriten më, ngase nuk shërbejnë për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e padiësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim tek gjyqtari përkatës.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e dt. 08 tetor 2013, e parashtruar tek AL për anulimin e ndarjes së mjeteve financiare të inkasuar nga pagesa e qirasë dhe kompensimi në shumën shtesë prej 712.96€ nga NSH „Amortizatorët“ (në likuidim), ishte refuzuar si e pavlefshëm me Vendimin nr. PRN 047- 0212, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ashtu si çdo punëtor i NSH-së është njoftuar në mënyrë të rregullt mbi shpërndarjen mjeteve dhe ka pasur të drejtë të parashtronte çdo ankesë ndaj shumes së përfituar të organet e menagjuese të NSH-së.

Me 01 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-2812, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar, e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN047-0212 të datës 08 tetor 2013.

Kolegji i Apelit, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, aktgjykimin e ankimuar dhe provat në shkresat e lëndës, gjeti se ankesa është e bazuar dhe lënda duhet të kthehet në rigjykim në bazë të arsyeve vijuese.

Autoriteti i Likuidimit(AL) refuzimin e kërkesës së paditësit e ka bërë pa ndonjë arsye specifike. AL nuk ka pasur ndonjë bazë ligjore për refuzimin e kërkesës së parashtruesit me arsyen se ai nuk e ka kontestuar listën në afatin e përcaktuar. Kolegji i Apelit gjeti se afati i përcaktuar nga NSH-ja dhe AKP-ja nuk mund të ketë efekt të afatit prekluziv.

Është e qartë se kërkesa e paditësit është një kërkesë kreditore ndaj NSH-së, ndërsa afatet për parashtrimin e kërkesave kreditore janë të sanksionuara me Ligjin e AKP-së nr.04/L-034, që nuk përkojnë me afatet e përcaktuara sipas vendimit mbi ndarjen e këtyre mjeteve monetare.

Kolegji i Apelit vëren se shkalla e parë ka marrë Aktgjykimin e ankimuar, duke e vërtetuar Vendimin e AL-së pa ndonjë analizë të mjaftueshme të fakteve relevante, jo në përputhje me ligjin, e që përcaktojnë të drejtën e punëtorëve për shumën e cila u takon nga një ndarje e tillë e mjeteve financiare. Për më tepër Kolegji i Apelit vlerëson se jo të saktë dhe të gabuar arsyetimin e dhen në aktgjykimin e shkallës së parë kur ka theksuar se në rastin konkret si çështje paraprake e kërkesës së paditësit në procedurë të likuidimit, është vlerësimi i vendimeve të NSH –së, në lidhje me kriteret për shpërndarjen e të hyrave të grumbulluara nga qiraja për punëtorët e NSH –së dhe se në rastin konkret kërkesa e paditësit si punëtor individual për tu anuluar kjo shpërndarje është e varur nga vendosja e padisë grimore në procedurë të rregullt. Ndërsa në anën tjetër ka theksuar se është pezulluar procedura sipas rastit SCC- 11- 0117 , që është vepruar sipas nenit 10, paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, procedura e pezulluar sipas nenit 10, paragrafi 3 i të njëjtit ligj ajo mundë të vazhdoi vetëm me miratimin e kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Kolegji i Apelit vlerëson se pezullimi i vendosur në lëndën SCC- 11- 0117 nuk e pengon Shkallën e parë në vendosjen e kësaj çështje juridike të paditësit, dhe se heqja e pezullimit mund të bëhet nga gjykata dhe nuk varet nga dëshira e paditësit. Andaj kjo bazë ligjor e refuzimit të kërkesës së paditësit nuk është e mbështetur në dispozita ligjore.

Në procedurën e rigjyimit, Gjyqtari përkatës i Shkallës së parë të DHPGJS duhet të analizoj të gjitha faktet relevante për të drejtat e punëtorëve, për shumën që u takojnë, kriteret sipas të cilave është bërë një ndarje e tillë, që për më shumë duket të jenë jo të drejta e të pa bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Shkalla e parë duhet në mënyrë specifike të përcaktoj nëse shuma që i është ndarë ankuesit/paditësit është adekuate, me kriteret e përcaktuara, dhe të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në linjën e cekur më lartë të arsytimit ligjor, për raste të këtilla siç është edhe ky rast, në jurisprudencën e vet të më parme, Kolegji i Apelit ka vendosur edhe në rastet tashmë të mbyllura AC-I-14-0346, AC-I-15-0027 dhe AC-I-16-0263.

Për arsytet e lartë cekura, pretendimet ankimore të paditësit janë të bazuara dhe Kolegji i Apelit e aprovon ankesën dhe e anulon aktgjykimin e ankimuar si joligjor duke kthyer lëndën në rigjykim.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 30 euro me datë 26 prill 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 02 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____